



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë. 21.11.2012

Nr. 0204-1193

PËR: Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës
Jakup Tërrnava, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës,

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS NR, 154, 162, 163, 164,

Të pranuar më datën: 07/11/2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit. Nr, 154, 162, 163, 164 të miratuar me datë 25.11.2012 nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, KONFIRMON ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendimi nr.154, ku aprovet propozimi për rritjen e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2012;
- Vendimi nr.162, për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës, me të cilin qytetarët kanë qenë të kushtëzuar të bëjnë pagimin e faturave për mbeturina ndaj Kompanisë Regjionale "Pastrimi" ;
- Vendimi nr.163, për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës , për lejimin e shfrytëzimit të përkohshëm të sipërfaqes prej 3 ari,pjesë e Ngastrës Kadastrale;
- Vendimi nr.164, për formimin e Komisionit për verifikimin e pronave të Komunës se Fushë-Kosovës.

Me respekt,
Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana. 21.11.2012
Br. 0204-1193

Za: Burim Berisha, Gradonačelnik Opštine Kosovo Polje
Jakup Tërrnava, Predsedavajući Skupštine Opštine Kosovo Polje,

PREDMET: POTVRDA ZAKONITSOTI ODLUKA SKUPŠTINE OPŠTINE KOSOVO POLJE
BR, 154, 162, 163, 164,

Primljeno dana: 07/11/2012

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040 , Zakonu br. 03/L-049 o Finansijam lokalne samouprave , dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti KABINETA Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke. br, 154, 162, 163, 164 usvojene dana 25.11.2012 od Skupštine Opštine Kosovo , POTVRDJUJE zakonitost akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akta koja proizvode pune pravne efekte :

- Odluka br.154, usvajanje predloga zapovećanje sopstvenih prihoda za fiskalnu 2012;
- Odluka br.162, zaukidanje Odluke Skupštine Opštine, gde su građani bili uslovljeni da plate fakture za smeće prema regionalnoj kompaniji "Pastrimi" ;
- Odluka br.163, za ukidanje Odluke SO , za dozvolu priveremenog ukidanja površine od 3 ara, deo Kadastralne parcele;
- Odluka br.164, za formiranje Komisije za proveravanje imovine u Opštini Kosovo Polje .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik Premijera i Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar u MALS-a
Direktorima uprava i kancelaria
Arhivi MALS-a



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

HYRËSE-ULAZNA INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLAHA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum 07.11.2012

Data
Datum

Tipi i organizatës	Nr. i Lendës	Shtojca	Vlera
II	204-105		



Datë: 25.10.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.10.2012, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 145, të datës 19.10.2012, paraqitur nga Drejtoria për Financa, Buxhet dhe Pronë, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, shkronja (c dhe ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për rritjen e të hyrave vetiake për vitin fiskal 2012, në shumë totale prej 315,000.00€, të shpërndara nëpër kategorit ekonomike, kodet e programeve dhe projektit si vijon:


Nr.	Fondi.B	Kodi. Eko	Kodi i prog.	Kodi i projkt.	Përshkrimi	Shuma
1.	21	30 Buxheti	17502	85083	Bashkëfinanc në projekt	100,000.00€
2.	21	20 Buxheti	17502		Subvenc dhe transfer	10,000.00€
3.	21	20 Kultura	85002		Subvenc dhe transfer	10,000.00€
4.	21	20 Adm. Arsím	92010		Subvenc dhe transfer	10,000.00€
5.	21	20 Adm.Shëndetësi	73011		Subvenc dhe transfer	20,000.00€
6.	21	11 Adm.Shëndetësi	73011		Paga dhe medijtje	10,000.00€
7.	21	11 Sh.M.Grameno	93031		Paga dhe medijtje	60,000.00€
8.	21	13 Adm. Personel	16302		Mallëra dhe shërbime	2,000.00€
9.	21	13 Infrast.Publike	18162		Mallëra/shërb(Qeraja)	70,000.00€
10.	21	13 Adm.Shëndetësi	73011		Mallëra dhe shërbime	3,000.00€
11.	21	13 Adm. Arsím	92010		Mallëra dhe shërbime	10,000.00€
12.	21	14 Infrast.Publike	18162		Komunali	10,000.00€

- II. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë.

- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FEZH dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





162 06.11.2012

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.11.2012


Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.10.2012, pas shqyrtimit të propozimit Nr. 150, të datës 19.10.2012, paraqitur nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Mjedis, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në Rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 158 të datës 22.06.2012, nenin 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

- I. Për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 47, të datës 07.04.2010, me të cilin qytetarët kanë qenë të kushtëzuar të bëjnë pagimin e faturave për mbeturina ndaj Kompanisë Regjionale 'Pastrimi', për marrjen e dokumentit të taksës rrugore komunale për regjistrimin e automjeteve.
- II. Zbatimi i këtij vendimi është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë, Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës dhe shfuqizon Vendimin Nr. 47, të datës 07.04.2010.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për FBP, Drejtorisë për PUKGJ, Drejtorisë për SIFM dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



162 06.11.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 06.11.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.10.2012, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 102, të datës 17.08.2012, mbështetur në kërkesën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 0202-939/9, të datës 17.09.2012, bazuar në nenin 40.2, shkronja (I), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

VENDIM ✓

- I. Për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 102, të datës 17.08.2012, për lejjimin e shfrytëzimit të përkohshëm të sipërfaqes prej 3 ari, pjesë e Ngatrës Kadastrale Nr. 428, e evidentuar në Fletën Poseduese UL-72514036-01555, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, për palën Hatixhe Ramadani, me destinim për ndërtimin e objektit të përkohshëm për banim.
- II. Zbatimi i këtij vendimi është në kompetencë të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës dhe shfuqizon Vendimin Nr. 102, të datës 17.08.2012.

162

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për PUKGJ dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



164 06.11.2012



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.11.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.10.2012, bazuar në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008) dhe nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

- I. Për formimin e Komisionit për verifikimin e pronave të Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej:
 1. Shaban Ademi - Kryetar i Komisionit,
 2. Nazmi Kelmendi - anëtar,
 3. Ahmet Graiçevci - anëtar,
 4. Hasan Gjyrevci - anëtar dhe
 5. Enver Asllani - anëtar.
- II. Detyrë e Komisionit është që brenda afatit prej 120 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij Vendimi të bëjë verifikimin dhe shënimin e pronave të Komunës në secilën Zonë Kadastrale të territorit të Komunës së Fushë-Kosovës.
- III. Për verifikimin dhe shënimin e pronave të Komunës, Komisioni i raporton dhe ofron dokument me shkrim, Kuvendit të Komunës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë për PUKGJ dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

